



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2024:055922
Datë: 03.06.2024
Numri i dokumentit: 05768465

C.nr.1999/24

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil, gjyqtari Gazmend Ajvazi, me bashkëpunëtorin profesionale Bionda Rexhepi, në çështjen kontestimore të paditësit Xh. Rr. nga fshati Zhegër, komuna e Gjilanit, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Malsore Halili, avokate nga Vitia, kundër të paditurës Komuna e Gjilanit – Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti kompensimi i shpërblimit jubilar dhe shpenzimeve të ushqimit, me vlerë të kontestit 760.45 euro, jashtë seance gjyqësore, më datë 27.05.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditësit Xh. Rr. nga fshati Zhegër, komuna e Gjilanit dhe DETYROHET e paditura Komuna e Gjilanit – Drejtoria Komunale e Arsimit, që në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit, për periudhën kohore 01.09.2021-18.11.2021, për 38 ditë pune, duke llogaritur nga 2 euro në ditë për t’ia paguaj shumën prej 76.000 euro, me kamatë ligjore prej 8 % nga data 16.02.2024, si datë e paraqitjes së padisë e deri në pagesën përfundimtare, në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarrimit ligjor.

II. REFUZOHET e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit, përkatësisht kërkesa për shpërblimin jubilar, në shumën prej 684.45 euro.

III. DETYROHET e paditura që t’ia paguaj shpenzimet e procedurës paditësit në shumën e përgjithshme prej 99.00 euro, në afat prej 7 ditë, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarrimit ligjor.

A r s y e t i m

Paditësi, përmes të autorizuarit të tij, më datë 16.02.2024 ka paraqitur padi në këtë gjykatë kundër të paditurës për kompensimin e shpërblimit jubilar dhe shpenzimeve të ushqimit, në vlerë prej 760.45 euro.

Në padi ka theksuar se paditësi është i punësuar te e paditura, në Shkollën Fillore të Mesme të Ulët (në vijim: SHFMU) “Agim Ramadani” në Zhegër, në cilësinë e zëvendës drejtorit, deri më datë 18.11.2021, kur edhe është pensionuar. Bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë

(në vijim: KKAK) të datës 22.01.2021 ka shtuar se paditësit i takon kompensimi për shpenzimet e ushqimit për periudhën kohore 01.09.2021 – 18.11.2021 dhe shpërblimi jubilar prej 150 % për 40 vite përvojë pune. Gjykatës i ka propozuar të aprovojë të bazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe të detyrojë të paditurën t’ia kompensojë kompensimin e shpenzimeve të ushqimit në shumën prej 76.00 euro dhe shpërblimit jubilar në shumën prej 456.3 euro. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar në shumën prej 104.00 euro për përpilim të padisë dhe 21.00 euro për taksë gjyqësore.

E paditura me shkresën e datës 04.12.2023 ka parashtruar përgjigje në padi lidhur me të gjitha çështjet kontestuese sa i përket kërkesave: shpërblim jubilar, ushqim, udhëtim, kualifikim dhe inflacion, të cilat rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit e vitit 2017 dhe 2021 si dhe Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, nr.01/33 të datës 29.08.2008. Meqë objekt kontesti i kësaj çështje juridike është kompensimi i shpenzimeve të ushqimit dhe shpërblimit jubilar, gjykata vlerëson se kjo shkresë shërben si përgjigje në padi në lëndën konkrete. Kundërshtimet e të paditurës theksojnë se sa i përket kompensimit të shpenzimeve për udhëtim, të njëjtat nuk duhet të njihen nëse nuk argumentohen me prova përkatëse (certifikatë e vendbanimit, pagesë mujore në kompani transportuese, çmimi i biletës...). Sa i përket diferencës në pagë për shkak të kualifikimit, vendimi i qeverisë në fjalë është zbatuar sipas detyrës zyrtare posa ka hyrë në fuqi (me rastin e rritjes së pagave), andaj vendimi i njëjtë nuk mund të zbatohet dy herë. Sa i përket inflacionit, kjo e drejtë nuk i takon të punësuarve në sektorin e arsimit, pasi nuk mund të godet vetëm një sektor të punësimit, por të gjithë sektorët e aparatit shtetëror. Për të gjitha kërkesat, gjykatës i ka propozuar të vlerësojë parashkrimin e tyre, bazuar në nenin 87 të Ligjit të Punës dhe kërkesave periodike nga Ligji për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi ka konstatuar se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seance gjyqësore, bazuar në nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), në të cilin është përcaktuar se “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit merititor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilin e pranon si të themeltë kërkesëpadinë” dhe 399.1 që përcakton se “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do te jep vendimin merititor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”.

Gjykata ka gjetur se mes palëve nuk është kontestuese se paditësi ka qenë i punësuar te e paditura që nga data 07.02.1978 deri më datë 18.11.2021, kur ka shkuar në pension, ndërsa për periudhën kohore 01.09.2021 – 18.11.2021 ka gjithsej 38 ditë pune (fakt i vërtetuar nga vërtetimi nr.prot.332/2023 i dt.22.11.2023 i lëshuar nga SHFMU “Agim Ramadani” në Zhegër); as nuk është kontestuese se paga bazë e paditësit është 421.00 euro (fakt i vërtetuar nga lista e pagës e lëshuar nga BRK).

Gjykata bazuar në nenin 329.1 të LPK-së, provat në shkresat e lëndës i gjeti vendimtare për vendosje në këtë çështje meritore, pasi të njëjtat janë lëshuar nga organi shtetëror – këtu vet e paditura, brenda kufijve të kompetencës së vet, duke provuar saktësinë e thënieve në këto dokumente.

Gjykata vlerësoi se nuk ekzistojnë pengesa tjera për dhënien e vendimit meritor, pasi themelësia e kërkesëpadisë, e aprovuar si në pikën I të dispozitivit dhe jo themelësia e kërkesëpadisë e refuzuar si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi del bazuar në dispozitat e nenit 55, paragrafi 1 të Ligjit të Punës që përcakton se “I punësuar ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit”; nenit 90, paragrafi 5 se “Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”; lidhur me dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021, nga neni 3, paragrafi 2 që përcakton se “I (e) punësuar do të thotë punëtor ose punëtore, i/e cili/cila ka lidhur marrëdhënie pune në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi, Kontratës Kolektive në nivel të vendit dhe kësaj kontrate”; neni 35, paragrafi 7 se: “Të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune është 2€ (dy euro) për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit të kuzhinës ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensimin për ushqim”; paragrafi 8, pika 8.4 se “Punëtorët (anëtarë të SBASHKUT-ut), në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit, ashtu që për 40 vite të përvojës së punës i kompensohet 150 % të pagës bazë.

Dispozitat e Kontratave Kolektive të Arsimit për vitin 2021 aplikohen për periudhën 22.01.2021 – 21.11.2022, zbatimi i të cilave është në përputhje edhe me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës, nr.214/2023 të datës 05.10.2023.

Nga të theksuarat më lartë, gjykata vendosi t’ia aprovojë pjesërisht të bazuar kërkesëpadinë paditësit si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi gjeti se të njëjtit i takon kompensimi i shpenzimeve të ushqimit për ditët e pranisë në punë për periudhën kohore 01.09.2021-18.11.2021, ndërsa lartësinë e vërtetoi duke ia llogaritur nga 2 euro në ditë, si në nenin 35.7 të KKAK-së.

Për kamatën, gjykata vendosi në bazë të nenit 382 të LMD-së.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi sa i përket shpërblimit jubilar, pasi gjeti se paditësi më datë 07.02.2018 ka arritur vitin jubilar prej 40 vite përvojë pune, ndërsa bazuar në nenin 87 të Ligjit të Punës, padia është parashtruar më datë 16.02.2024, kurse kërkesa nuk është llogaritur për 3 vite mbrapa nga dita e parashtrimit të kërkesës, përkatësisht është paraqitur pas 6 vite që kur paditësi ka fituar të drejtën të kërkojë shpërblimin jubilar. Në rastin konkret, kjo kërkesë e paditësit për shpërblimin jubilar është e parashtruar.

Gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi, bazuar në dispozitat ligjore nga neni 449, 452, 38 dhe 463 të LPK-së, duke marrë parasysh suksesin e paditësit në këtë procedurë dhe kërkesën e specifikuar për këto shpenzime, ndërsa sa i përket lartësisë së shpenzimeve të procedurës u bazua në nr. tarifor 6 dhe 7 të Rregullorës për Tarifën e Avokatëve të Kosovës,

ashtu që për përpilim të padisë llogariti shumën prej 78.00 euro, për shkak të kontestit të vlerës së vogël (nën 500.00 euro).

Nga të lartëcekurat, bazuar në nenin 143, paragrafi 1 lidhur me nenin 398 dhe 399 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil
C.nr.1999/24, datë 27.05.2024

Gjyqtari,
Gazmend Ajvazi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë, në afat prej 7 ditë, pas ditës së pranimit të të njëjtit. Ankesa dorëzohet në dy ekzemplar përmes kësaj gjykate.